

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE  
NR. 30623

**V E N D I M**  
**PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK**

Sot me date 03.12.03, une, gjyqtarja e Gjykates Shkalles se pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e ortakeve Z. Anesti Zguro, Namir Braho e Rafael Marko te cilat kerkojne regjistrimin e shoqerise "VOSKOPI" SHPK ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar

**K O N S T A T O V A :**

Se kerkesa e kerkuesit per regjistrimin e shoqerise tregtare te emertuar "VOSKOPI" sh.p. k. me ortake Z.Anesti Zguro,Namir Braho e Rafael Marko , me kapital themeltar 100.000 leke, te ndare Z. Anesti Zguro 33.3% te kapitalit,Z.Namir Braho 33.3% te kapitalit, Z,Rafael Marko 33.3% te kapitalit, administratore te shoqerise z.Anesti Zguro, seli ne Komunen Voskop te rrethit Korce, me kohezgjatje te veprimtarise te papercaktuar mbi 10 vjet , me objekt te veprimtarise :

- Ushtrimin e aktivitetit te sherbimit telefonik me system kabllor si dhe tregtimin e paisjeve dhe aparaturave telefonike, import eksport.
- Improt – Eksport,tregtim I artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice dhe pakice.
- Tregtim I artikujve te ndryshem industriale, ushqimore
- Tregtim I produkteve te ndryshme bujqesore,blektorale,fruta perime .
- Punime te ndryshme servisi, te automjeteve te ndryshme.
- Tregtim automjesh te cdo lloji,marka e tonazhi si dhe pjese kembimi per to.
- Tregtim karburantesh te ndryshme, vajra lubrifikante, lande djegse te cdo lloji e tipi me pakice.
- Tregtim makinerish te ndryshme e paisje industriale dhe bujqesore e venin e tyre ne shfrytezim.
- Tregtim paisjesh elektro shtepiake,higjeno sanitare dhe hidraulike,prodhime qeramike,artizanati paisje higjeno sanitare te te gjitha llojeve .
- Trasport mallrash te te gjitha llojeve,brenda dhe jashte vendit.

- Transport mallrash te te gjitha llojeve,brenda dhe jashte vendit.
- Tregtimin e materialeve te ndertimit e lendeve te para brenda dhe jashte vendit.
- Tregtim plehrash e prodhime te tjera kimike.
- Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Hapje e shfrytezim hotelesh, baresh, restorante,diskoteka, qendra pushimi e curative.
- Punime duralumini e tregtim I tyre.
- Punime druri, tregtime prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi etj.

Kunder vendimit mund te behet ankim.

GJYQTARE  
*Blendi Lleshi*  
*Blendi*

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**  
 NR. 30623/1

**V E N D I M**  
**I GJYQTARES SE VETME**

Sot me date 04.05 2004, une, gjyqtarja e Gjykeses se shkalles se pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen per depozitim ne regjistrin tregtar te vendimit ortakut dhe administratorit te shoqerise tregtare "VOSKOPI" SHPK . dhe dokumentave te tjera te paraqitura nga kjo shoqeri .

**K O N S T A T O V A :**

Me vendimin nr. 30623 dt.03.12.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "VOSKOPI" sh.p. k.

Ne baze te aktit te themelimit dhe statutit te saj, shoqeria eshte e perbere nga ortakët Anesti Zguro, Namir Braho dhe Rafael Marko, me 33,3% te kapitalit

Me vendimin nr. 1, dt.05.04.2004, Z. Namir Braho ja shet 33,3 % te kuotat e kapitalit ne pjese te barabarta prej 16.65%, Z.Anesti Zguro dhe Rafael Marko te cilet behen Anesti Zguro me 50% te kapitalit dhe Rafael Marko me 50% te kapitalit. Administratot mbetet z.Anesti Zguro.

.Ngarkohet administratori te kryeje veprimet per depozitimn e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimn e vendimit nr. 1, dt. 05.04.2004 te ortakeve ne regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE :**

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar:"

Nr

Rregjistrimi .


30623

URDHER RREGJISTRIMI

Emri : "Voskopja" sh.p.ç.  
Selia : Voskopje  
Objekti: Shërbime telefonike kablore, internet dhe  
trepërme; alarim dhe udhëtim, arsimi dhe  
përkrahje, tregëtim, kalërimi dhe praktikë,  
transport, punime dhe alarim, dhe tregëtim.  
Kapitali : 100.000 lekë  
Ortaket : Anesta Gjuro 33.3%, Namik Bealio 33.3% Rafael  
Marko 33.3%  
Administrator: Anesta Gjuro  
Kohe zgjatja : pa afat  
Statuti : 97+154  
Akti i Themelimit : 57+154  
Data e nënshkrimit të Statutit : 29.11.03  
Data e Rregjistrimit : 02.12.03  
Shënime - Tregëtim bankare e BK - Depo  
Tregëtim dt. 21.11.03

GJYQTARE

BLERINA MUÇA



## KONTRATË

### PËR THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGËTARE

### ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “VOSKOPF” SH.P.K.

1. **Anesti ZGURO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 1965, lindur dhe banues në fshatin Voskop të Rrethit Korçë.
2. **Namir BRAHO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop të Rrethit Korçë.
3. **Rafael MARKO**, i biri i Lytfit, i dtl. 1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop të Rrethit Korçë.

Të tre madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në bazë të legjislacionit shqipëtar, kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, marëveshjen për themelimin e shoqërisë tregëtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “VOSKOPI” sh.p.k. e cila do të rregullohet në mbështetje të Ligjës nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të Ligjës nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregëtare”, ligjës nr. 7667 datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregëtar”, si dhe të legjislacionit shqipëtar në fuqi dhe normave që vijnë:

#### NENI 1


Të themelojnë një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “VOSKOPF” sh.p.k.


“VOSKOPF” sh.p.k. është një subjekt juridik shqipëtar, të cilit i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë.

Shoqëria “VOSKOPF” sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqipëtar.

#### NENI 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregëtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të kontributit të derdhur në kapitalin themelor.

Anesti Zguro  


Namir Braho  


Rafael Marko  


### NENI 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Ushtrimin e aktivitetit të shërbimit telefonik me sistem kabllor si dhe tregëtim të pajisjeve dhe aparaturave telefonike import-eksport.
- Import-eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë.
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrialë dhe ushqimore.
- Tregëtimin e produkteve të ndryshme bujqësore ,blegtorale,fruta-perime.
- Punime te ndryshme servisi , te automjeteve te ndryshme .
- Tregëtim karburantesh të ndryshme,vajra lubrifikante,lëndë djegëse të çdo lloji e tipi, me pakicë .
- Tregëtim automjeteve të çdo lloji, marka e tonazhi si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tregëtim makinerish të ndryshme e paisje industriale e bujqësore e vënien e tyre në shfrytëzim.
- Tregëtim paisje elektro shtëpiake,higjeno-sanitare dhe hidraulike,prodhime qeramike,artizanati pajisje higjeno sanitare tete gjitha llojeve .
- Transport mallrash të të gjitha llojeve,brenda e jashtë vendit.
- Tregëtimin e materialeve të ndërtimit e lëndëve të para brenda e jashtë vendit.
- Tregëtim plehrash e prodhime të tjera kimike.
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Hapje e shfrytëzim hotelesh,baresh,restorante ,diskoteka,qendra pushimi e kurative.
- Punime duralumini e tregëtimi i tyre.
- Punime druri, tregëtime prodhimesh të ndryshme druri, mobilje ,orendi etj.

### NENI 4

Shoqëria "VOSKOPI" sh.p.k e ka selinë e saj në Komunën Voskop të Rrethit Korçë.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda e jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë,filiale,agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë në mënyrë ambulatorie me njësi apo duke hapur zyra si dhe ti suprimojë ato.

Arestis Zeyno  
AZ

Monica Broho  
MB

Robert Morko  
RM

#### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë "VOSKOPI" sh.p.k është 100 000 lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

#### NENI 6

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesmarjes së secilit ortak

si më poshtë:

Anesti ZGURO.....	33.3 ( tridhjetë e tre pikë tre )%
Namir BRAHO.....	33.3% ( tridhjetë e tre pikë tre )%
Rafael MARKO .....	33.3 ( tridhjetë e tre pikë tre )%

Përcaktohet këtu se ortakët kanë të drejtë të kontribuojnë në kuotën e tyre të pjesëmarrje duke transferuar në pronësi të shoqërisë "VOSKOPI" të mira materiale.

#### NENI 7

Kohëzgjatja e shoqërisë "VOSKOPI" sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

#### NENI 8

I gjithë kapitali themelor është i ndarë në 100 pjesë të barabarta ku secila pjesë është e përbërë nga 1000 lekë.


I gjithë kapitali i vënë nga të tre ortakët themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.


#### NENI 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë tregëtare "VOSKOPI" sh.p.k. do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të tre ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

#### NENI 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesmarjes në kapitalin themelor si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë ,pasi të jete lënë një shumë mënjanë të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Anesti ZGURO  


Namir Braho  


Rafael Marko  


### NENI 11

Në kohën prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit ,kur nuk ka zgjatje afati, kapitali i shoqërisë mbasi të hiqen debitet e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesmarjes në kapitalin themelor.

### NENI 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë ,mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat shqipëtare ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

### NENI 13

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

të derdhin kuotën kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në Nenin 6.

të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë.

të tërheqin fitimin e realizuar.

të tërheqin aktivin rezultatant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit

të shoqërisë.

të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë.

- të impenjojnë për arritjen e objektivave të shoqërisë.

### NENI 14

Organet e shoqërisë "VOSKOPI" sh.p.k.. janë :

- asambleja e ortakëve të shoqërisë.


- administratori i shoqërisë.


Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.


Administrator i shoqërisë do të jetë z. Anesti ZGURO.

### NENI 15

Shoqëria tragëtare private "VOSKOPI" sh.p.k.. është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht ligjeve nr.7512 ,datë 10.08.1991,nr.7638 ,datë 19.11.1992 ,nr 7667 ,datë 28.01.1993,të Kodit Civil si dhe të akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Anesti Zguro  


Nomir Broho  


Rojzel Ullorho  




**NENI 16**

*Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit nr.7961 ,datë 12.07.1995 ( Kodi i Punës ) si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.*

**NENI 17**

*Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate ,palët do ti zgjidhin në rrugë miqësore në të kundërt kompetenca për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së rrethit Tiranë.*

**NENI 18**

*Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.*


**NENI 19**

*Kjo kontratë është përpiluar në katër kopje origjinale.*


*Korçë ,më datë 21.11.2003*

**ORTAKËT THEMELUES**

**Anesti ZGURO**

*Anesti Zoguro*  


**Namir BRAHO**

*Namir Braho*  


**Rafael MARKO**

*Rafael Marko*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE KORÇE

Nr. 38/93 Prot.

Nr. 21/88 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Vërtetohet se sot më dt. \_\_\_\_\_ 2003 (dymijë e tre) u paraqitën personalisht para meje noteres Flora Shuaip Biba, shtetasit e mëposhtëm:

1. **Anesti ZGURO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 25/05/1965, lindur dhe banues në Voskop të Rrethit Korçë, me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me nr. 77/44.
2. **Namir BRAHO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 02/11/1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop, të Rrethit Korçë, me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me nr. 77/44.
3. **Rafael MARKO**, i biri i Lytfit, i dtl. 15/01/1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop të Rrethit Korçë me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me Nr. 75/97.

Të tre janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të verifikuar prej meje sipas dokumentave përkatës të identifikimit, nënshkruan para meje noterit statutin dhe kontratën e themelimit të Shoqërisë Tregëtare "VOSKOPI" Sh.p.k.

NOTERI  
FLORA SH. BIBA



## STATUT

### I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

#### “VOSKOPI” SH.P.K.

Shoqëria “VOSKOPI” sh.p.k është krijuar mbi bazën e kontratës midis tre ortakëve themelues të saj.

1. **Anesti ZGURU**, i biri i Bashkimit , i dtl. 1965, lindur dhe banues në fshatin Voskop Korçë.
2. **Namir BRAHO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop, Korçë.
3. **Rafael MARKO**, i biri i Lytftiut, i dtl. 1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop, Korçë.

Statuti është akti bazë ku do të mbështetet themelimi i shoqërisë tregëtare private “VOSKOPI” sh.p.k me përgjegjësi të kufizuar ,si dhe zhvillimi i mëtejshëm i veprimtarisë së saj.

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj shoqërie, në përputhje me ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991, nr. 7638, datë 19.11.1992 si dhe 7667, datë 28.01.1993 është përpiluar ky statut me kërkesat e ligjës për shoqëritë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 1 EMËRTIMI

Shoqëria është quajtur “VOSKOPI” sh.p.k.

Ajo është një subjekt juridik ,shqipëtar ,të cilit i lind e drejtatë ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë.

Shoqëria “VOSKOPI” sh.p.k zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj (kontrata dhe statuti).

#### NENI 2 OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë “VOSKOPI” sh.p.k do të jetë:

- Ushtrimin e aktivitetit të shërbimit telefonik me sistem kabllor si dhe tregëtim të pajisjeve dhe aparaturave telefonike, import – eksport.

Anesti Zguro  
AZ

Namir Braho  
NB

Rafael Marko  
RM

- Import – eksport, tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me shumicë dhe pakicë.
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrialë dhe ushqimore .
- Tregëtimin e produkteve të ndryshme bujqësore ,blegtorale,fruta-perime.
- Punime te ndryshme servisi, te automjeteve te ndryshme .
- Tregëtim karburantesh të ndryshme, vajra lubrifikante, lëndë djegëse të çdo lloji e tipi, *me pakice*
- Tregëtim automjesh të çdo lloji, marka e tonazhi si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tregëtim makinerish të ndryshme e paisje industriale e bujqësore e vënien e tyre në Shfrytëzim
- Tregëtim paisje elektro shtëpiake, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati dhe pajisje hidrosanitare te te gjitha llojeve
- Transport mallrash të të gjitha llojeve, brenda e jashtë vendit.
- Tregëtimin e materialeve të ndërtimit e lëndëve të para brenda e jashtë vendit.
- Tregëtim plehrash e prodhime të tjera kimike.
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Hapje e shfrytëzim hotelesh, baresh, restorante , diskoteka, qendra pushimi e kurative.
- Punime duralumini e tregëtimi i tyre.
- Punime druri, trgëtime prodhimesh të ndryshme druri, mobilje ,orendi etj.

### NENI 3

Për kryerjen e veprimtarisë së saj ,shoqëria do të hapi njësi grumbulluese, përpunuese, shërbimi e tregëtuese si dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

### NENI 4 SELIA

Shoqëria **VOSKOPI sh.p.k** e ka selinë në Komunën Voskop të Rrethit Korçë.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda e jashtë teritorit te Republikës së Shqipërisë filiale ,agjensi përfaqësimi, seli sekondare si dhe ti suprimojë ato. Çdo ndryshim i selisë do të bëhet me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

*Anesti Zygo*  
*[Signature]*

*Stamir Broko*  
*[Signature]*  
2

*Rafael elortko*  
*[Signature]*

**NENI 5**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

**NENI 6**  
**KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë, është 100.000 lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

**NENI 7**

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesmarjes të secilit ortak, si më poshtë:

Anesti ZGURO.....	33.3 %
Namir BRAHO.....	33,3 %
Rafael MARKO ... ..	33.3%

Përcaktohet këtu se ortakët kanë të drejtë të kontribuojnë në kuotën e tyre të pjesmarjes duke transferuar në pronesi të shoqërisë **VOSKOPI sh.p.k** të mira materiale .

**NENI 8**

I gjithë kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë të barabarta ku secila pjesë është e barabartë me nga 1000 lekë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë tërësisht dhe plotësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga të tre ortakët themelues.

**NENI 9**

Transferimi i kuotave bëhet vetëm me akt noterial. Çdo transferim i kuotave tek të tretët i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë.

Kuotat e kapitalit janë lirish të transferueshme midis ortakëve.

Ortaku që ka ndërmend të cedojë kuotat e veta, përpara duhet ti komunikojë shoqërisë projektin e transferimit. I takon ortakut tjetër të shoqërisë të ushtrojë të drejtën e parablerjes .

Anesti Zguro

Namir Braho

Rafael Marko

Nëse shoqëria nuk jep përgjigje brenda një muaji nga marja e projektit të transferimit, miratimi konsiderohet i dhënë. Nëse ortakët duan të blejnë, të ushtrojnë të drejtën parablerjes, ata duhet të ushtrojnë këtë të drejtë brenda një muaji nga marja e projektit të transferimit, në rast të kundërt ata duhet të lejojnë transferimin e kuotave të tretëve. Kushtet e ofruara të tretëve, nuk duhet të jenë më të favorshme nga ato të ofruara ortakëve.

Në rast se lind nevoja për vlerësimin e kuotave ortakët caktojnë ekspert. Në rast se një gjë e tillë nuk arrihet prej tyre, caktimi i ekspertit caktohet nga Gjykata e rrethit Tiranë.

### **NENI 10**

Shoqëria mund të rritë kapitalin themelor ose mund të zvogëlojë atë, por gjithnjë jo nën kufirin 100 000 lekë që përcaktohet në Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar ".

Shtimi ose pakësimi i kapitalit bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve dhe simbas kërkesave të ligjës.

### **NENI 11**

Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve e pasardhësve. Në rast vdekje të ortakut, pjesët e kapitalit themelor që disponon i kalojnë trashëgimtarëve të tij dhe kur asnjëri nga pjestarët e familjes nuk pranon të punojë në ortakëri atëhere u jepen të gjitha fitimet që i takojnë simbas kontributit të hedhur në kapitalin themelor.


Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të drejtat e detyrimet përkatëse të ortakut.


### **NENI 12**


Fitimi i realizuar nga ushtimi i veprimtarisë ekonomike i shoqërisë do të administrohet nga ortakët e shoqërisë. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregëtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

### **NENI 13**

Shoqëria është disponuese dhe përdoruese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë e të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale ose jo materiale, duke përfshirë dhe të drejtë për shitjen e pasurisë së vet tek të tretët.

Anesti Zaimo  


Namir Basha  


Rafael Morko  


Në Republikën e Shqipërisë **VOSKOPI sh.p.k.** gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik ose fizik, shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 14**

Shoqëria ka të hapur llogarinë e saj rrjedhëse në Bankë, nëpërmjet së cilës kryhen veprime ekonomike financiare me partner të tretë vendas dhe të huaj, duke likujduar në monedhë shqiptare apo të huaj, sipas marrëveshjes të përfunduar midis tyre.

#### **NENI 15**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

Asambleja e ortakëve.

Administratori i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi vendimor i shoqërisë .Ajo mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret të paktën dy herë në vit mbas mbylljes së vitit financiar dhe kur aprovohet programi i veprimtarisë për vitin e ardhshëm.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret kur administratori i shoqërisë e quan të përshtatëshme për kërkesat e shoqërisë. I takon asamblesë të jashtëzakonshme të bëjë ndryshime në Statutin e shoqërisë, të pakësojë ose të shtojë kapitalin themelor, të shpërndajë para afatit Shoqërinë ose të shtyjë aktivitetin e saj ortakëve. Çdo ortak mund të përfaqësohet në depozituar në librin e ortakëve.

#### **NENI 16**


Asambleja e ortakëve drejtohet nga Administratori I shoqërisë . I takon ketij të fundit të verifikojë rregullshmërinë e pjesmarjes së ortakëve. Çdo ortak mund të përfaqësohet në Asamblene nga një ortak me ane të nje akti me delegim të nënshkruar sipas firmës së depozituar në librin e ortakëve


Për të mbajtur procesverbalin e mbledhjeve të Asamblese caktohet nje sekretar që mund të jetë edhe një Noter . Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Administratori I Shoqërisë, nga sekretari dhe nga gjithë pjesmarresit .


Vendimet e Asamblesë të marra në përputhje me ligjin dhe me këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët prezent ose jo.

#### **NENI 17**

Oragani administrator i shoqërisë është Administratori i shoqërisë .Ai zgjidhet nga asambleja e ortakëve dhe qëndron në detyrë për gjithë kohëzgjatjen

Alexi Zguro  


Naim Braho  


Rafael Morko  


e aktivitetit përveç rasteve të një revokimi eventual nga vetë Asambleja e Shoqërisë.

Administratorë të shoqërisë **VOSKOPI sh.p.k. u caktua z. Anesti ZGURO.**

### **NENI 18**

Administratorit të shoqërisë i takon administrimi i zakonshëm i shoqërisë përveç kur kjo gjë sipas ligjës apo Statutit i rezervohet Asamblesë së ortakëve.

I takon Administratorit të Shoqërisë të përfaqësoj Shoqërinë përpara të tretëve dhe në gjykim. Ai gëzon të drejtën e firmës së Shoqërisë.

Administratori mund ti delegojë të drejtat e veta një personi të tretë të autorizuar me shkrim për të përfaqësuar shoqërinë si dhe të kryej veprime dhe praktike të ndryshme në emër të tij

### **NENI 19**

Asambleja e ortakëve të shoqërisë ka këto kopetenca ,të marrë këto vendime :

Të miratojë programin e veprimtarisë së Shoqërisë,të hartojë raportet e administrimit ,inventaret dhe llogaritë vjetore. Vendosi për shpërndarjen e shoqërisë ,për ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve. Rregullon mardhëniet e punësimit dhe ato të shpërbllimit brenda shoqërisë.Emëron dhe shkarkon administratorë,ekspertë kontabël.


Bën ndryshime e plotësime në statut dhe në kontratën e themelimit,vandos për rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themelor,kalimin e kapitalit të tretëve ndryshimin e kohës së veprimtarisë ,shndërimin e shoqërisë në një formë tjetër,likuidimin e shoqërisë. Simbas akteve ligjore bën shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shtetërore, personave juridikë ose fizikë , vendas e të huaj.


### **NENI 20**


Kontrolli financiar i shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar ose të emëruar nga asambleja e ortakëve me një afat prej tre vitesh financiare të njëpasnjëshme me mundësi riemërimi.

### **NENI 21**

Çdo vit financiar fillon në një Janar të çdo viti dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parrë ku si fillim është data e regjistrimit të Shoqërisë.

Anesti Zguro  


Samir Braho  


Rafael Morica  




## NENI 22

Llogaritë vjetore, inventaret, raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët apo ekspertët kontabël miratohet nga asambleja e ortakëve. Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda një afati 3-mujor, mbas datës së shlyerjes së vitit financiar.

## NENI 23

Mosmiratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit asambleja e ortakëve vendos e krijon fondin ligjor por mund të krijojë edhe fonde të tjera. Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së sigurimeve shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogarri likuiduese pranë Bankave të vendit dhe të kryejë veprimtari likuiduese nëpërmjet tyre.

## NENI 24

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij, janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor e deklaratën e të ardhurave dhe ti depozitojnë në organin financiar të Zyrës së Tatimeve.

## NENI 25

Marëdhëniet e punësimit brenda shoqërisë, rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në përputhje me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 si dhe legjislacioni tjetër shqipëtar që bën fjalë për punësimin.

## NENI 26

Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së Shoqërisë si dhe duke njoftuar organet e punës së juridiksionit ku ushtron veprimtarinë Shoqëria. Largimi nga puna ose ndryshimi i vendit të punës bëhet në bazë të një akti të lëshuar me shkrim nga Administratori i Shoqërisë.

Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore ose dhe vetë me kërkesën e vetë të interesuarit. Largimi nga Shoqëria bëhet mbasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet materiale dhe monetare.

## NENI 27

Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë drejtpërdrejt në tregun e lirë si dhe me persona fizikë ose juridikë vendas ose të huaj. Në veprimet kontraktuale, shoqëria përfaqësohet nga administratori i shoqërisë

Anesti Izuel  
AKL

Hamir Bnoho  
AKL

Rafael Morleo  
AKL

**z. Anesti ZGURO.**

Ajo mund të përfaqësohet edhe nga persona të tjerë të përcaktuar prej tyre me prokurë. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

**NENI 28**

Shoqëria mund të prishet para afatit të caktuar në këtë statut në rast kur ndryshon afati ose kur ka një prishje të parakohëshme për shkaqe të tjera.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidatorë të cilët ndjekin operacionin e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin asamblesë së ortakëve rezultatet përfundimtare të likuidimit.

Në përfundim Asambleja e ortakëve vendos për heqjen e mandatit të tyre dhe të gjitha detyrimet që dalin nga akti i likuidimit, Asambleja e ortakëve i merr përsipër për t'i shlyer me kapitalin e ortakëve të Shoqërisë.

**NENI 29**

Të gjitha mosmarveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim brenda shoqërisë si dhe Shoqëria me të tretët apo midis ortakëve do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së rrethit Tiranë ku është edhe regjistri tregëtar i shoqërisë.

**NENI 30**


Çështjet e tjera të patrajtuara në këtë Statut do të mbështeten për zbatim në legjislacionin shqipëtar në fuqi sipas rastit konkret si në ligjin nr.7512, datë 10.08.1991, ligji nr.7638 ,datë 19.11.1992 , nr. 7667 ,datë 28.01.1993 dhe Kodi Civil si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre.


**NENI 31**


Ndryshimi i formës së Shoqërisë në një shoqëri me formë tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve kur plotësohen kushtet për krijimin e llojeve të tjera.

**NENI 32**

Asambleja e Shoqërisë mund të bëjë ndryshime e plotësime në çdo kohë në Statut e në kontratën e themelimit pa rënë ndesh në mënyrë thelbësore me Nenet që janë përshkruar në këtë Statut. Ndryshimet dhe plotësimet në Statut e në kontratën e themelimit bëhet në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vetë Statuti.

Anesti Zguro  


Manir Braha  


Rafael Moroko  


### ***NENI 33***

Shoqëria do të ketë vulën e saj me madhësi të zakonshme e me tekst përreth saj.

### ***NENI 34***

Statuti është hartuar me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve të dy ortakëve themelues dhe është nënshkruar prej tyre.

Statuti redaktohet në katër kopje për ti'u shpërndarë organeve kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

### ***ORTAKËT THEMELUES***

***Anesti ZGURO***

*Anesti Zguro*



***Namir BRAHO***

*Namir Braho*



***Rafael MARKO***

*Rafael Marko*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE KORCE

Nr. 3293 Prot.

Nr. 2188 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Vërtetohet se sot më dt. 24.11. 2003 (dymijë e tre) u paraqitën personalisht para meje noteres Flora Shuaip Biba, shtetasit e mëposhtëm:

1. **Anesti ZGURO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 25/05/1965, lindur dhe banues në Voskop të Rrethit Korçë, me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me nr. 77/44.
2. **Namir BRAHO**, i biri i Bashkimit, i dtl. 02/11/1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop, të Rrethit Korçë, me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me nr. 77/44.

**Rafael MARKO**, i biri i Lytftiut, i dtl. 15/01/1969, lindur dhe banues në fshatin Voskop të Rrethit Korçë me dokument identifikimi Certifikatë Lindjeje me Nr. 75/97.

Të tre janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të verifikuar prej meje sipas dokumentave përkatës të identifikimit, nënshkruan para meje noterit statutin dhe kontratën e themelimit të Shoqërisë Tregëtare "VOSKOPI" Sh.p.k.

NOTERI  
FLORA SH. BIBA



K E R K E S E

3 B Mucës  
02 DHJETOR 2003  
[Signature]

KERKUES : Anesti Zguro , i biri i Bashkimit , i dt. 1965 , lindur dhe banues ne fshatin Voskop te rrethit Korçë .

ME OBJEKT: Kerkoj regjistrimin si person juridik te shoqerise me përgjegjesi te kufizuar "VOSKOPI"sh.p.k. me seli ne Komuna Voskop , rrethi Korçë .

BAZA LIGJORE : Ligji 7638 date 19.11.1992 " Për shoqerite tregëtare " dhe ligji 7667 dt.28.01.1993 " Për regjistrin tregëtar".

GJYKATES SE SHKALLES SE PARË  
T I R A N E

Une kerkuesi Anesti Zguro se bashku me ortakët e tjere Namir Braho dhe Rafael Marko , kemi themeluar shoqerine " Voskopi " sh.p.k. konform legjislacionit shqiptar e me aktet e themelimit te saj

Për te bere te mundur zhvillimin e aktivitetit te kesaj shoqerie me seli ne fshatin Voskop te rrethit Korçë kerkojne nga ana e Gjykatës se shkalles se pare Tirane, regjistrimin ne regjistrin tregëtar si person juridik.

Kjo shoqeri do te zhvilloje aktivitetin e saj bazuar ne Statutin dhe Kontraten e themelimit te saj .

ashkelidhur kesaj kerkese ju parcesim Statutin dhe Kontraten e themelimit te shoqerise tregëtare me përgjegjesi te kufizuar "VOSKOPI" sh.p.k. si dhe Akt marrëshjen për ngurtesim fondesh e cila mban daten 21.11.2003.

KERKUES  
ANESTI ZGURO

Anesti Zguro  
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
ZYRA E NOTERISE KORÇE

Nr. 3293 prot  
Nr. 1138 Kol.

VERTETIM NENESHKRIMI

Vertetohet se sotm me dt. 24-11-\_\_\_ (dymije e tre ) u paraqit personalisht para meje noterit Flora Shuaib Biba administratori i firmes "VOSKOPI" sh.p.k; Anesti Zguro i biri i Bashkimit i dt. 25.05.1965 me dokument identifikimi certificate me nr. 77/44.

Madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili neneshkruan para meje noterit , kerkesen per regjistrimin si person juridik te shqerise tregtare "VOSKOPI" sh;p.k.

Mbasi u sigurove per identitetin e tij dhe i gjete dokumentat konform ligjit e neneshkruaj edhe une

NOTE RE  
FLORA BIBA



**AKT - MARRËVESHJE**

( Për ngurtësim fondesh )

E lidhur sot me datë 21 Nëntor 2003, midis Degës së Bankës së Kursimeve, përfaqësuar nga  
Z. Sotirag Filo me detyrë Drejtor nga  
njëra anë dhe Firmes Voskopi  
që më poshtë quhet "klienti" përfaqësuar nga Z. Anesti Zyuro  
me detyrë Drejtoret firme, nga ana tjetër, me objekt:  
Ngurtësimin e fondeve pranë Bankës së Kursimeve në garanci për kyrim firme  
export - import  
në favor të Gjykatës (Cisane)  
që më poshtë quhet "përfitues".

**TË DREJTAT DHE DETYRAT E PALËVE**

Klienti autorizon bllokimin në llogarinë (depozitën) e çelur në Degën e Bankës së Kursimeve  
( Agjensinë Nr. \_\_\_\_\_ ) me Nr. \_\_\_\_\_ shumën prej 100.000  
Nje qind mijë lekë.  
Afati i ngurtësimit do të jetë deri më datën pa afat  
Ky afat mund të ndërpritet vetëm kundrejt urtënies me shkrim të përfituesit të kësaj garancie.  
Për periudhën e bllokimit në llogari klienti përfiton interesa bankare në masën \_\_\_\_\_ %.  
Komisioni bankar për veprimin e kryer është 1500 lekë, ose USD \_\_\_\_\_  
për veprime në valutë.


Interesat llogariten dhe kontabilizohen në përputhje me praktikën bankare: Për përdorimin e gjëndjes në  
llogari ose në depozitë përpara afatit të caktuar për periudhën e mbetur llogaritet interesi ditor në përputhje me  
kushtet e punës të Bankës së Kursimeve.

Fotokopjet janë të pavlefshme. Nëse ato përdoren banka nuk mban asnjë përgjegjësi.

Akt - marrëveshja përpilohet në tre ekzemplarë. Ekzemplari numër një i jepet klientit ndërsa dy të tjerët i mbe-  
ten Degës së Bankës së Kursimeve, një nga të cilët mbetet në dosje dhe një i përcillet sektorit të Kontabilitetit  
në Agjensinë nr. \_\_\_\_\_ për veprimet përkatëse.

KLIENTI

PËR DEGËN E BANKËS SË KURSIMEVE KORÇË

Anesti Zyuro  


SOTIRAG FILO

DREJTORI I DEGËS





30623/1

KERKUESI

3 B DUKES  
30 PRILL 2004  
*[Signature]*

KERKUESI Anesti Zguro, dt.lindje 25.05.1965, me nr. dokumeti 1782026 madhor me zotesi te plote per te vepruar. Banues ne Voskop Korce

OBJEKTI: Depozitim in ne regjistrin tregtar te vendimit nr 1, dt. 05.04.2004 Te shoqerise " VOSKOPI" shpk dhe te kontrates se shitjes kuotave

Baza ligjore: Ligji 7632 dt.04.11.1992 dhe 1638,dt.19.11.1992

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Me vendimin nr. 30623,dt.03.12.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " VOSKOPI."sh.p. k.me seli ne fshatin Voskop Korce.

Me vendimin nr. 1 dt. 05.04.2004, ortaku Namir Braho ja shet pjesen e tij te kapitalit prej 33.3% ortakeve te tjere Anesti Zguros dhe Rafael Markos, te cilet jane dakort ta blene pjesen e tij te kapitali prej 33.3%. Me largimin e ortakut Namir nga shoqeria, ortakët Anesit Zguro behet me 50% te kapitalit dhe Rafael Marko behet me 50% te kapitalit. Administrator I shoqerise mbetet Anesti Zguro

Per te gjitha keto ndryshime:

1. Ngarkohet administratori te kryeje veprimet per depozitim in e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.
2. Ne keto kushte kerkoj depozitim in e ketyre ndryshimeve prane regjistrit tregtar.

*Bi depozitimi me kerikeme  
dt. 04.05.04*

Me respect  
Anesi Zguro

*Anesti Zguro*  
*[Signature]*

*Vendim Nr 1 dt. 05.04.04  
i An Oktokete*

*Kontrate shitjeje Nr 1026/815  
dt. 12.04.04*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE KORCE


Nr. 1027 Rep.

Nr.            Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 12. 4. 2004 para meje noteres u  
paraqit personalisht:

Arasti Ljeto me dat. lindje 25. 1965, me nr.  
dokumenti 1782026 ne moshe madhore i afte per te kryer veprime  
juridike i njohur prej meje per identitetin e te cilit u sigurova me  
leternjoftimet perkatese, i cili deklaroi se eshte dakord me dokumentin e  
nenshkroi ate para meje pa verejtje.



NOTERE  
FLORA BIBA

PULLE TAKSE



SHOQERIA TREGETARE "VOSKOPI" SHPK  
K O R C E

V E N D I M  
Nr. I date 05/04/2004

Asambleja e ortakeve e mbledhur ne daten e sotme mori ne shqyrtim kerkesen e Administratorit ANESTI ZGURRO, per shitjen e kuotave te kapitalit qe disponojne ortakët e tjere NAMIR BRAHO ne favor te dy ortakeve te tjere dhe mbasi diskutoi rreth kesaj ceshtje:

K O N S T A T O I S E:

Shoqeria tregtare "VOSKOPI" SHPK eshte themeluar nga ortakët Anesti Zguro, Naim Braho, Rafael Marko qe disponojne sejcili nga 33.3 % te kuotave te kapitalit prej 100.000 leke, e ka per objekt veprimtarie te ushtrimit te aktivitetit te sherbimit telefonik me sistem kabllor si dhe tregetin e pajisjeve de aparaturave telefonike, import-eksport etj, sikurse rezulton nga permbajtja e vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane nr.30623 date 03/12/2003.

Ortaku Namir Braho ka kerkuar te lejohet te shese kuotat e tij te kapitalit prej 33.3 % kundrejt vleres 33 300 Lek ne favor te dy ortakeve te tjere Anesti Zguro dhe Rafael Marko, duke u larguar nga shoqeria si ortak. Nga ana e tyre dy ortakët e tjere Anesti Zguro dhe Rafael Marko pranojne te blejne 33.3 % te kapitalit fillestar ne vlere 33 300 Lek te ortakut te larguar duke mbetur tashme dy ortake dhe administrator perseri Anesti Zguro. Me marrjen e ketij vendimi ortakut Namir Braho nuk mban asnje pergjegjesi per detyrimet qe krijon shoqeria, ne te ardhmen. Meqenese kerkesa e tij eshte e bazuar ne Statutin e Shoqerise, duhet pranuar.

Per keto arsye:

Asambleja e Ortakeve bazuar ne Statutin e Shoqerive tregtare te Ligjit 7638 dt.19.11.1992

V E N D O S I:

I.- Te lejoje shitjen e kuotave te kapitalit nga ortakut Namir Braho tek ortakët Anesti Zguro dhe Rafael Marko, veprim i cili duhet te behet me akt noterial.

Vendimi te regjistrohet ne regjistrin tregetar.


Vendimi hyn ne fuqi ne daten e sotme.


ORTAKET THEMELUES


ANESTI ZGURRO

RAFAEL MARKO

NAMIR BRAHO

Anesti Zguro  


Rafael Marko  


Namir Braho  




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE KORCE  
Nr.Rep. *2024*

VERTETIM NENESHKRIMI

Sot me date 05/04/2004 ,u paraqiten para meje: Anesti Zguro, Rafael Marko, Namir Braho te njohur prej meje , e cilet neneshkruan pa verejtje vendimin e Asamblese se ortakeve te shoqerise ketu para meje noteres.

NOTERI  
FLORA BIBA

PULLE TAKSE



REPUBLIKA E SHQISËS

SHKËMBI I TIRANËS

Nr. 1026 rep

Nr. 8/5 kol.

KONTRATE SHITJEJE KAPITALI FILLESTAR

Set me date 12.4.2004 (dyshembëjet prill dytije e katër) ditën e hënë, para meje Flora Biba notere u paraqiten personalisht palët ;

SHITËS : NAMIR BASHKIM BRANO dat.lindja 2.11.1969 me nr. dokumenti 1233501

BLERËS : ANISTI BASHKIM ZGURU dat.lindja 25.5.1965 me nr. dokumenti 1782026

2. RAFAEL LYTI MARKO dat.lindja 15.1.1969 me nr. dokumenti 75/97

Palët janë sadhore të afte për të kryer veprimet juridike të pa njohur prej meje për identitetin e të cilëve u sigurova me dokumentet përkatëse të cilët kerkuan redaktimin e kesaj kontrate hit blerje kapitali me përmbajtjen që vijon ;

Te tre palët shitesit dhe dy blerësat deklarojnë se janë ortakë të shoqërisë tregëtare " VOJASOPI " SHPK ,shoqëri e cila është rregjistruar me nr. vendimi 30623 date 3.12.2003., duke pasur secili nga 33,3% të kapitalit fillestar.

Me vendimin e asamblesë së ortakëve nr. 1 date 5.4.2004 është vendosur lejimi i shitjes të pjesës kapitalit të Namir Bashkimit tek me dy blerësat e tjerë.

Pra shitesit Namir deklaroi se është plotësisht dakort që pjesën e tij të kapitalit fillestar të shoqërisë pikërisht 33,3% tja u shesë me pjesë të barabarta blerësve Anesti Zguro dhe Rafael Marke kundrejt çmimit prej 33.300 (tridhjet e tresije e treqind ) lek shumetë cilën e kam marrë plotësisht dhe jashtë kesaj zyre.

Nga ana e tyre blerësat Anesti Zguro dhe Rafael Marke deklarojnë se janë plotësisht dakort me blerjen e 33,3% të kapitalit fillestar të shoqërisë të pjesës tij shitësit Namir kundrejt çmimit prej 33.300 (tridhjet e tresije e treqind ) lek shumetë cilën e kemi dhënë shitesit plotësisht dhe jashtë kesaj zyre.

kesaj kontrate i bashkëngjiten dhe këto dokumenta një vendim i asamblesë ortakëve një kopje të vendimit të gjykatës të Tiranës.,mbas blerjes behen ortakë me barabarta 50% Anesti dhe 50% Rafaili.

SHITËS

BLERËS

NAMIR BASHKIM BRANO

ANISTI BASHKIM ZGURU

RAFAEL LYTI MARKO

Namir Brano

Anesti Zguro

Rafail Marko

